



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1838/1 prot.,

Datë 11.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*MEKTRIN MOTORS*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me numër reference Nr. *REF-47464-05-09-2025*, me objekt: “*Blerje zjarrfikse dhe automjete shërbimi Pick Up për ARRSH*”, me fond limit 99,760,000leke pa TVSH, zhvilluar më datë 12.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*START CO*” SHPK me NIPT: L11614001S dhe me adresë: *Bulevardi “Gjergj Fishta” Kulla “G&P”, Kati 1, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Persona të interesuar:** Operatori ekonomik “*MEKTRIN MOTORS*” SHPK me NIPT: *K51408501P* dhe me adresë: *Autostrada Km.6 XHAFZ, Durrës.*

Në datën 10.07.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2025/5543 datë 10.07.2025, dhe me numër protokolli nr. 1838/2025 prot, datë 10.07.2025 e operatorit ekonomik “*START CO*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me numër reference Nr. *REF-47464-05-09-2025*, me objekt: “*Blerje zjarrfikse dhe*

automjete shërbimi Pick Up për ARRSH”, me fond limit 99,760,000leke pa TVSH, zhvilluar më datë 12.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 3 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “START CO” SHPK, në ankesën me nr. 1838/2025 prot, datë 10.07.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” SHPK.

“2.3 Kapaciteti teknik:

2. *Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.*

5. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.*”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 11.07.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro